

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ZONAT
E STIMULUARA

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	1-18
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	2-3
3. Konkluzioni i përgjithshëm	3-4

II.Hyrje..... 5-5

a. Titulli.....	5-6
b. Marrësi.....	5-6
c. Objektivat dhe qëllimi.....	5-6
d. Identifikimi i çështjes.....	5-6
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	5-6
ë. Përgjegjësitë e audituesve.....	5-6
f. Kriteret e vlerësimit.....	5-6
g. Standardet e Auditimit.....	5-6
h. Metodatat e auditimit.....	5-6
i. Dokumentimi i auditimit.....	5-6

III. 1, Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit1-1

III.2, Përshkrimi i i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit1-2

2Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET.....17-18

III. DOKUMENTACION SHOQËRUES18-19

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë .06.2019 “DVASHK Lezhë dhe DVASHK Shkodër, sipas Programit të Auditimit nr. 397/1, datë 13.04.2021, për veprimtarinë nga data 01.05.2018 deri më datën 31.12.2020 ,e për periudhën 6 mujori të vitit 2022, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se: Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë, janë lënë **34 rekomandime** gjithsej, nga këto: **20 masa organizative** dhe 13masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 13 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë: Për përmirësimin e gjendjes nga 20 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht **9 rekomandime**, janë në proces zbatimi **6 rekomandime**, pa pranuar **4** dhe pa zbatuar **1 rekomandim**.

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “vërejtje deri në largim nga puna” për 13 punonjës, nga ku rezulton se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, ka dërguar shkresë pwr njoftim për marrjen e masave disiplinore të rekomanduara, për rrjedhojë konsiderohen ne proes zbatimi.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

1. Gjetje nga auditimi: Nga DVASHK Zonat e Stimuluara, legalizimi i objektit informal, sipas lejes së legalizimit nr. 705118, datë 17.12.2019 objekt banimi 2-kat, pasuria nr. 8/91/1, ZK3101, Qerret, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara, për rastin e evidentuar më sipër, të kërkojë nga DVASHK Durrës statusin juridik të pronës dhe nëse objekti figuron në kartelat e pasurive të paluajtshme i regjistruar në emër të përfituesit të lejes së legalizimit, të kërkojë kufizimin e pronës dhe të fillojë procedurat ligjore për shfuqizimin e kësaj leje.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

1. Gjetje nga auditimi: DVASHK Zonat e Stimuluara për efekt të përshpejtimit dhe përballimit të ngarkesës së legalizimeve, krahas organikës ka punësuar edhe punonjës provizor, duke lidhur kontrata pune për vitin 2018, 2019 dhe 2020 me miratim të Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK sipas vendimit 23 datë 26.12.2019. Kështu për vitin 2020 organika përbëhet nga 20 punonjës, ndërsa punonjës provizor paraqiten 25 persona nga 690 gjithsej DPASHK. Nga auditimi u konstatua se:

a. numri i punonjësve provizore për 3 vitet (2018-2019-2020) paraqitet më i lartë se numri i punonjësve në organike, në vend që të ndodhte e kundërta, çka tregon se planifikimi i numrit i punonjësve krahasuar me nevojat e punës nuk ka qenë i saktë.

b. nuk janë lidhur kontrata definitive për punonjësit provizor, në zbatim të Kodit Punës, pasi punësimi i tyre ka kaluar periudhën mbi 3 vjet (2018-2021), duke vazhduar procesi me kontratë të përkohshme.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave mbi page të DVASHK Zonat e Stimuluara, për vitin 2018-2019-2020, u konstatua se: Në mënyrë të pa argumentuar është përfituar zëri shtesa mbi page “për kushte pune tjera”, pasi nuk përcaktohen se cilat janë këto kushte të tjera dhe kjo është aplikuar vetëm për institucionin e ASHK, sipas listë pagesave të vitit 2018, 2019 dhe 2020. Kjo shtese për “kushte pune tjera” është përfituar për 3 vitet nga gjithë personeli prej 37 personash duke përfshirë dhe punonjësit provizor me nga 5,000 lekë/muaj deri 20,000 lekë/muaj për secilin ose gjithsej rreth 5 milion lekë për çdo vit. Pagesa e shtesës “për kushte pune tjera” bazohet tek VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK”, vendimi cili nuk flet për këtë shtese, por thotë referuar lidhjes nr. 2, ku edhe kjo lidhje nuk flet dhe nuk identifikon kushtet e tjera të punës, por pasqyron vlerat sipas punonjësve në një kolonë të veçantë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të ndërpresë menjëherë shtesën e pagës “për kushte pune të tjera”, si të pajustificuar dhe pa mbështetje ligjore, në të kundërt në bashkëpunim me KM të saktësojë dhe përmirësojë VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK” dhe lidhjen nr. 2, të cilat nuk përcaktojnë asnjë kusht pune.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga ana e KLSH me shpresat përcjellëse **34 rekomandime** gjithsej, nga këto: **20 masa organizative** dhe 13 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 13 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë: Për përmirësimin e gjendjes nga 20 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht **9 rekomandime**, janë në proces zbatimi **6 rekomandime**, pa pranuar **4** dhe pa zbatuar **1 rekomandim**.

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “vërejtje deri në largim nga puna” për 13 punonjës, nga ku rezulton se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, ka dërguar shkresë për njoftim për marrjen e masave disiplinore të rekomanduara, për rrjedhojë konsiderohen në proces zbatimi.

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës në DVASHK Zonat e Stimuluara u konstatuan shkelje financiare në 2 raste për vlerën 53,000 lekë, shpenzime të pajustificuara konkretisht:

* vlera 33,000 lekë, shpenzime pastrimi të pajustificuara, sipas urdhër shpenzimit nr. 49 datë 18.07.2019, pasi: institucioni ka të punësuar në organike pastrues, madje pastrimi (dizefektimi) i zyrave AKSH është kryer njëherë nga “N-86” shpk (urdhër shpenzimit 50 datë 18.07.2019) si dhe praktika e pagesës paraqet mangësi dokumentare (mungon projekti, preventivi, situacioni i sipërfaqes gjelbëruar). Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

* vlera 20,000 lekë, tatim në burim, sipas urdhër shpenzimit nr. 48 datë 18.07.2019 dhe MP datë 21.08.2020, pasi 2 faturat e thjeshta nr. 2, datë 04.08.2020 dhe 16.07.2019 për vlerën 200,000 lekë nuk janë të modelit tatimor, çka ka krijuar efekt negativ financiar, në kundërshtim me pikën 52 të UMF 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me VKM 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypin dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor” .

1.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të nxjerrë përgjegjësitë për sa më sipër dhe të marrë masa në të ardhmen, për shpenzimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve në mënyrë që të eliminohet probabiliteti i mundësisë së krijimit të efekteve negative financiare.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **në proces.**

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **33 rekomandime** gjithsej, nga këto: **20 masa organizative** dhe 13 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 13 punonjës, në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 20 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti nuk janë pranuar 4, ndërsa zbatimi tyre rezulton: janë zbatuar plotësisht 9 rekomandime, janë në proces zbatimi 6 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 1 rekomandime.

b. Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “vërejtje deri në largim nga puna” në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm, nga ku rezulton se janë në proces zbatimi.

II - HYRJJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 705/8 datë 07.09.2022 nga data 05.09.2022 deri në datën 24.09.2022, në Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021”.

Auditimi përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

A. M. (Përgjegjësi i Grupit)

V. B, R.A, SH.H dhe R.K.

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 795/8 datë 07.09.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Marrësi – Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara

3. Objektivat dhe qëllimi

Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtorinë e Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara Tiranë, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

4. Identifikimi i çështjes

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë, është person juridik, publik jo buxhetor, në varësi të Kryeministrisë dhe ka për objekt të veprimtarisë:

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë është themeluar në maj të vitit 2019 përmes ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”. Me ngritjen e këtij institucioni kanë pushuar së ekzistuari Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimeve (ALUIZNI), kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilave tanimë ushtrohen prej ASHK-së.

- Analizimi i riskut të veprimtarisë së Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë me qëllim përcaktimin e pikave të auditimit është bërë në kuadër të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2020.

- Veprimtaria buxhetore dhe financiare e Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat. Të ardhurat, që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës. Si garanci për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga veprimtaria kadastrale, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë krijon fondin rezervë vjetor, dhe i arketon në llogari të ASHK së, në masën që përcaktohet nga këshilli drejtues.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë Miraton projekt programin buxhetor afatmesëm dhe projekt programin vjetor të veprimtarisë së vitit të ardhshëm financiar, të cilat ia propozon ministrit përgjegjës për financat, Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë; Miraton drejtimet politike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, që lidhen me çështje të përditësimit të informacionit në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave.

Drejtori i Përgjithshëm:

Të drejtojnë aktivitetin e Agjencisë në fushat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të zbatimit të legjislacionit për çështjet e pronësisë, sipas objektivave politike të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës; Të hartojnë projektprogramin buxhetor afatmesëm dhe projektprogramin vjetor të veprimtarisë së vitit të ardhshëm financiar; Të hartojë programe dhe miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë; Detyra të tjera të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

7. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligj nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar; Ligj nr. 10186, datë 05.11.2019 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

9. Metodat e auditimit

Përraritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë: Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.

Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara Tiranë, për periudhën objekt auditimi ka për objekt të veprimtarisë:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zonat e Stimuluara rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

II-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë .06.2019 "Mbi auditimin tematik me objekt zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për periudhën 6 mujori të vitit 2021", Programit të Auditimit nr. 795/8 datë 07.09.2022, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Drejtoria Përgjithshme e ASHK Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, me nr. 21, lidhur me njoftimin për hartimin e programit të punës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK Zonat e Stimuluara është kthyer përgjigje me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Kjo shkresë është protokolluar në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara me nr. 1095/4, datë 21.09.2021.

Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK Tiranë, është kthyer përgjigje me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

- Nga titullari i institucioni është nxjerrë Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, por për zbatimin e tyre janë marrë masa nga specialistët e të gjithë sektorëve përkatës të prekur në Raportin Përfundimtar të KLSH, rast pas rasti sipas detyrave të gjithsecilit. Përkatësisht me shkresën nr. 9108 datë 04.05.2022, është kthyer përgjigje për marrjen e masave për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse shkresën nr. 397/11, datë 17.09.2021 janë lënë **34 rekomandime** gjithsej, nga këto: **20 masa organizative** dhe **13masa disiplinore**, nga "Vërejtje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punës", për 13 punonjës.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 20 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht **9 rekomandime**, janë në proces zbatimi **6 rekomandime**, **pa pranuar 4 dhe pa zbatuar 1.**

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces /pjesër isht	Pa pranuar	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
			Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek				
1.	Masa organizativ	20	9	6	4	1			-	-			-	-
2.	Masa përmirësim ligjor	0												
3.	Shpërblim demi	0												
4.	Masa efekt financiar	1		1										
5.	Masa disiplinore	13												
	Totali	34	9	7	4	1				-			-	-

Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga DVASHK Zonat e Stimuluara, legalizimi i objektit informal, sipas lejes së legalizimit nr. 705118, datë 17.12.2019 objekt banimi 2-kat, pasuria nr. 8/91/1, ZK3101, Qerret, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara, për rastin e evidentuar më sipër, të kërkojë nga DVASHK Durrës statusin juridik të pronës dhe nëse objekti figuron në kartelat e pasurive të paluajtshme i regjistruar në emër të përfituesit të lejes së legalizimit, të kërkojë kufizimin e pronës dhe të fillojë procedurat ligjore për shfuqizimin e kësaj leje.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i argumentuar në shkresën nr. 1095/3 prot., datë 26.07.2022.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, DVASHK Zonat e Stimuluara, në 5 raste ka vepruar me 2 standarde, lidhur me procedurat për legalizimet, pasi:

*ka pasur vonesa të pajustificuara dhe diferencime midis subjekteve, konkretisht: në dhënien e lejes legalizimit 704808 datë 28.06.2019 ka pasur ritme të përsheptuara në procesin e këtij legalizimi, madje shumica e dokumentacionit është përgatitur brenda 1 dite të zbardhjes lejes, ndryshe nga rastet tjera ku janë vonuar legalizimet.

* ka diferencim subjektsh lidhur me afatin e procedurave të legalizimit në të njëjtën ZK, përkatësisht: në ZK 3072, Velipojë Shkodër, për rastin e lejes legalizimit 705661 datë 27.10.2020 ajo është dhënë pas 17 vjetëve (2003-2020), ndërsa pas 5 vjetëve (2013-2018) është legalizuar ndërtimi informal 1-kat i ngritur në vitin 2013, madje i papërfunduar, sipas lejes së legalizimit 704321 datë 04.09.2018.

* nuk shpjegohet vonesa e legalizimit në vitin 2020, për lejen e legalizimit 705661, datë 27.10.2020, për objekt 2-kat social-ekonomik, pasuria nr. 1103/12/1, ZK 3072, Velipojë, në një kohë që gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor është përfunduar në vitin 2019.

Po kështu është vepruar me lejen e legalizimit 705182 date 28.01.2020, objekt banimi 3-kat, pasuria 37/23/1, ZK 3101, Golem, Qerret, e cila është dhënë 1 vit jashtë afatit ligjor nga kualifikimi i ndërtimit informal datë 16.10.2018, në kundërshtim me nenin 28 “Dhënia e lejes së legalizimit” të ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar,

* lidhur me njoftimin e subjektit për marrjen e lejes së legalizimit ka standarde të ndryshme, pasi për lejen e legalizimit 704290, datë 17.08.2018 nuk ka njoftim, në kundërshtim me pikën 5 të vendimit 954 date 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, te procedurave dhe formularit lejes legalizimit” përforcuar me ligjin 20 date 05.03.2020, ndërsa për lejen legalizimit 705661 date 27.10.2020 disponohet njoftimi i subjektit brenda afatit 30-ditor, sipas shkresës 4263 datë 26.11.2020.

2.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat Stimuluara lidhur me procedurat për legalizimet, të veprojë sipas një standardi, pa diferencime midis subjekteve dhe pa vonesa të pajustificuara, sipas përcaktimeve ligjore.

Koment -Me shkresën nr. 6846 prot., datë 31.03.2022, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së ka nxjerre rekomandimin mbi zbatimin me prioritet të praktikave të vitit 2005-2006 ku përfshihet dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së Zonat e Stimuluara. Shkresa bashkëlidhur

Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, në 27 raste dokumentacioni i verifikimit dhe riverifikimit në terren, procesverbali, grepnani, skicat dhe fotot paraqesin mangësi dhe parregullsi, pasi nuk plotësohen me të gjitha të dhënat që kërkohen, kanë korrigjime, kanë 2-3 mbi shkrime me tekstin “u rivëri fikua” pa urdhër të titullarit për riverifikim, pa akt të veçantë, genplanet dhe kualifikimet firmosen vetëm nga hartografi duke mënjanuar sektorin e pronësisë, fotot nuk janë të qarta dhe nuk paraqesin ambientet e kufitarëve dhe pa datën e fotografimit, etj, në kundërshtim me Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet” shfuqizuar, me udhëzimin nr. 30 datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 36, me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851 datë 27.05.2015 të Drejtorit Përgjithshëm ALUIZNI dhe me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” neni 16/4.

3.1.Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të marra masa që specialistët e terrenit të mbajnë dokumentacionin e terrenit me saktësi, të plotë dhe sipas kërkesave ligjore, për ndërtimet informale në legalizim, përkatësisht: procesverbalet, genplanet, skicat fushore dhe fotografitë e objekteve.

Koment -Me urdhrin nr. 146, datë 04.10.2021, është kërkuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara, zbatimi i të gjithë rekomandimeve të lëna nga ana jonë.

Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë komunikimit elektronik ka njoftuar të gjithë punonjësit e terrenit për të rikujtuar urdhrin e drejtorit nr. 146, datë 04.10.2021.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi:Në 10 raste dosjet e legalizimit rezultojnë të pa inventarizuara ose pjesërisht,pasi nuk ka numërimin sipas fletëve dhe dokumenteve, nuk ka marrës-dorëzues,në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

4.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të legalizimit sipas kërkesave ligjore.

Koment -Është ngritur grupi i punës i përbërë nga specialistët e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara për inventarizimin e praktikave. Bashkëlidhur kopje e inventarizimit të disa praktika sipas rekomandimeve të lëna

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se nga masat e rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 414/18 prot., datë 17.07.2019, rezultoi se nuk janë zbatuar 4 (katër) masa organizative dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme nuk është zbatuar rekomandimi për dhënien e masës disiplinore për 8 punonjës dhe ish-punonjës.

5.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara dhe Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e rekomandimeve. Të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin e masave organizative, dhe masave disiplinore rekomanduara më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 414/18 prot., datë 17.07.2019.

Komente: *Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DVASHK Zonat e Stimuluara, rezulton se për 137 praktika¹ të dala nga arkiva dhe që janë në proces pune, nuk janë respektuar afatet ligjore për procesin e legalizimit. Nga verifikimi i informacionit fizik dhe dixhital të paraqitur për këto praktika, rezulton se këto objekte informale ndodhen në zona të mbrojtura, shfaqin probleme me llojin e konstruksionit, ndodhen në distancë nga bregu i detit ku nuk lejohen ndërtime sipas dokumenteve të planifikimit të territorit, ndodhen pranë kanaleve kulluese, çënojnë projektet e infrastrukturës rrugore etj., e për pasojë duhet të ishin s,kualifikuar brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar

-Në 24 prej 137 rasteve të mësipërme, për objektet që janë evidentuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura si objekte që pozicionohen në nen zonën qendrorë 1a dhe 1b të Zonës së Mbrojtur të PMU/T “Lumi Buna - Velipojë”, ish-Drejtori i DVASHK Zonat e Stimuluara, duhet të kishte marrë masa për marrjen e vendimit për përjashtimin nga legalizimi të objekteve në përputhje me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve,

procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar .

6.1. Rekomandimi: Për 137 rastet e mësipërme, DVASHK Zonat e Stimuluara, në përmbushje të detyrave të saj, të bëjë verifikimet në terren për objektet të cilat nuk janë bërë matjet dhe të vijojë me procedurat e skualifikimit.

Bashkëlidhur disa kopje të Urdhrave të mos përfshirjes në procedurat e legalizimit.

6.2. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të marrë masa të evidentojë dhe të dokumentojë në një regjistër të veçantë objektet informale të cilat janë evidentuar dhe nuk plotësojnë kriteret e legalizimit, si dhe të marrë masat përkatëse për përjashtimin e tyre nga procesi i legalizimit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i argumentuar në shkresën nr. 9108 prot., datë 29.04.2022.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion nga DVASHK Zonat e Stimuluara konstatohet se:

- Për periudhën 01.05.2018-31.12.2018, nga 436 leje legalizimi të miratuara mungojnë vërtetimet për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 368 subjekte.

- Për vitin 2019, nga 574 leje legalizimi të miratuara mungojnë vërtetimet për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 133 subjekte.

- Për vitin 2020, nga 638 leje legalizimi të miratuara mungojnë vërtetimet për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 294 subjekte. Më datë 07.05.2020 në fuqi Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit subjekti nuk e ka detyrim paraqitjen e vërtetimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për rastet e konstatuara më sipër, Vendimet “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të shtetasve” e marra në mungesë të vërtetimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 27 dhe Ligjin 95/2018, datë 03.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, neni 27 pika 3/c .

7.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të evidentojë rastet për të cilat ka qenë detyrim ligjor kryerja e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë para lëshimit të lejes së legalizimit dhe të rakordojë me bashkitë përkatëse në lidhje me këtë çështje. Për rastet të cilat nuk është kryer kjo pagesë sipas përlllogaritjeve të bëra nga bashkia përkatëse, t’u kërkohet vendosja e kufizimit DVASHK-ve në juridiksionin e të cilave janë legalizuar objektet informale deri në plotësimin e dokumentacionit me vërtetimin për likuidimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Koment - Me urdhrin nr. 146, datë 04.10.2021, është kërkuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara, zbatimi i të gjithë rekomandimeve të lëna nga ana jonë.

-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë komunikimit elektronik ka njoftuar të gjithë punonjësit e terrenit për të rikujtuar urdhrin e drejtorit nr. 146, datë 04.10.2021.

Bashkëlidhur kopje e njoftimit të Bashkive përkatëse për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

8. Gjetje: Në 3 raste procesverbalit i verifikimit në terren në disa raste ka nënshkrimin e vetëm një specialisti të terrenit ndërkohë që verifikimi duhet të kryhet nga jo më pak se dy specialistë sipas formatit ligjor të procesverbalit të verifikimit.

8.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara të marrë masa që verifikimi në terren të bëhet nga jo më pak se dy specialistë dhe të evidentohet në procesverbalin përkatës i cili duhet të nënshkruhet nga ata dhe nga përgjegjësi i sektorit të hartografisë.

Koment;-Me urdhrin nr. 146, datë 04.10.2021, është kërkuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara, zbatimi i të gjithë rekomandimeve të lëna nga ana jonë. -Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë komunikimit elektronik ka njoftuar të gjithë punonjësit e terrenit për të rikujtuar urdhrin e drejtorit nr. 146, datë 04.10.2021.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast (Leja e Legalizimit me nr. 704855, datë 23.09.2019), DVASHK Zonat e Stimuluara ka legalizuar objektin ndihmës 1 kat, i mbuluar me karto serrë (material i lehtë i paqëndrueshëm) në kundërshtim me nenin 1/b, Kreu I të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016.

9.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara, për rastin e evidentuar më sipër, të kërkojë nga DVASHK përkatëse statusin juridik të pronës dhe nëse objekti figuron në kartelat e pasurive të paluajtshme i regjistruar në emër të përfituesit të lejes së legalizimit, të fillojë procedurat ligjore për shfuqizimin pjesërisht të kësaj leje.

Komente: dhe i argumentuar në shkresën nr. 1095/3 prot., datë 26.07.2022.

Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar

10. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet është konstatuar se genplani i përgatitur për objektet informale është nënshkruar për 2 pozicione pune nga i njëjti person, si për Sektorin e Hartografisë dhe për Sektorin e Çështjeve të Pronësisë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

10.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara, të marrë masa që në çdo rast të hartimit të dokumentacionit tekniko-ligjor që shërben për lëshimin e lejeve të legalizimit, çdo specialist të nënshkruaj dokumentacionin në përputhje me kompetencat dhe detyrat e ngarkuara sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve të dala në zbatim të tyre, duke evituar kështu konfliktin e mundshëm të interesit.

Komente:Me Urdhrin nr. 15, datë 31.01.2022, të Kryeministrit është miratuar Struktura dhe Organika e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,ku është përcaktuar pozicioni i përgjegjësit të Sektorit të Çështjeve të Pronësisë dhe Juridike për Drejtorinë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara.

Me Urdhrin nr. 961, datë 17.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë dhe Juridike i cili nënshkruan edhe genplanin për pjesën takuese të këtij sektori së bashku me specialistin përkatës.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Një ndër problemet kryesore të konstatuara gjatë auditimit të DVASHK Zonat e Stimuluara është fakti se për shumicën e subjekteve të cilat duhet të ishin s, kualifikuar nga procesi i legalizimit janë kryer 2-3 herë për të njëjtin subjekt verifikimet në terren.

Riverifikimet në terren (jo vetëm për objektet e konstatuara me problematika në legalizim) janë kryer me pretendimin se mund të ketë pasur ndryshime të rrethanave, apo sepse janë tejkaluar afatet dhe duhet të ndiqej procedura e kualifikimit ndërkohë që edhe mbas riverifikimeve nuk janë respektuar afatet ligjore për procedurën e legalizimit. Këto argumente nuk kanë bazë ligjore.

Riverifikimet në terren mbartin një risk të madh, për shkak se objektet mund të kenë pësuar ndryshime strukturore në kohë, mund të jenë bërë shtesa anësore/në lartësi jashtë afateve, dhe si pasojë, për mungesë së hartave dixhitale për periudha të caktuara kohore, nuk mund të verifikohet nëse objektet/shtesat janë ndërtuar brenda afateve ligjore.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion për numrin e verifikimeve në terren, vihet re se për periudhën objekt auditimi janë kryer 571 matje të reja ndërkohë që numri i riverifikimeve për objektet e verifikuara më parë arrin në 984, pra 413 riverifikime më tepër.

Kjo praktikë pune tregon një mungesë të theksuar efience dhe efektiviteti, duke ulur ndjeshëm ritmet e procesit të legalizimit dhe e tejzgatur atë ndër vite, për shkak se specialistët e terrenit, të cilët kanë kryer riverifikime mbi bazën e urdhrave të Titullarit të institucionit dhe përgjegjësit të specialistëve të terrenit, mund të kryenin verifikime të subjekteve të pa verifikuara më parë, duke përshpejtuar ndjeshëm përfundimin e procesit të legalizimit.

-Janë konstatuar raste të praktikave për të cilat në dosje, pavarësisht se janë përgatitur skicat fushore nga specialistët të cilët kanë kryer verifikimin në terren, mungon procesverbal i verifikimit në terren, që nënkupton se ky procesverbal nuk plotësohet nga specialistët në kohën e evidentimit të objekteve në terren.

-Përgjithësisht nga DVASHK Zonat e Stimuluara nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose skualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është kryer verifikimi në terren, si dhe nuk është respektuar edhe afati 30 ditor për lëshimin (zbardhjen) e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit. Në 10 raste, zbardhja e lejeve të legalizimit është bërë mbas rreth 2 viteve vonesë nga marrja e vendimit për kualifikimin e objekteve. Për sa më lart është vepruar në mospërputhje me pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar dhe pikën 2 të VKM nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” .

11.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara të marrë masa për të evituar verifikimet disa herë për të njëjtët objekte, të përgatisë plane konkrete për të shqyrtuar kërkesat për legalizim dhe brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore, të bëjë matjet në terren dhe të dalë me vendim për kualifikimin/skualifikimin e objekteve, duke mundësuar kështu ofrimin e shërbimit në kohë ndaj qytetarëve dhe duke rritur transparencën për publikun, por njëkohësisht të shmangë edhe zvarritjen në kohë të përfundimit të procesit të legalizimit.

11.2. Rekomandimi:DVASHK të marrë masa që specialistët e terrenit të plotësojnë procesverbalin e verifikimit në terren dhe skicën fushore në kohën e evidentimit të objekteve në terren, për të evituar mundësinë e gabimeve në pasqyrimin e gjendjes faktike ndërtimore.

Komente -Me urdhrin nr. 146, datë 04.10.2021, është kërkuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Zonat e Stimuluara, zbatimi i të gjithë rekomandimeve të lëna nga ana jonë.

-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë nëpërmjet komunikimit elektronik ka njoftuar të gjithë punonjësit e terrenit për të rikujtuar urdhrin e drejtorit nr. 146, datë 04.10.2021.

-Edhe pjesa e legjislacionit është përmirësuar duke udhëzuar specialistët të kryejnë vetëm një verifikim në terren. (VKM nr. 1178, datë 24.12.2020).

Ky rekomandim konsiderohet në proces.

12. Gjetje nga auditimi: DVASHK Zonat e Stimuluara, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve për periudhën objekt auditimi, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit si dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura.

Titullari i Institucionit ka ngarkuar me urdhër specialistin përkatës për shqyrtimin e ankesave, i cili nuk ka një databazë të saktë për evidentimin e të gjitha ankesave të trajtuara dhe shërbimin ndaj qytetarëve.

12.1. Rekomandimi:DVASHK Zonat e Stimuluara të marrë masa për të krijuar një regjistër të veçantë për administrimin e ankesave, i cili duhet detyrimisht të përmbajë kredencialet e ankimesit, objektin e kërkesës/ankesës, datën, afatet e shqyrtimit të tyre dhe bazueshmërinë ligjore për zgjidhjen e tyre, duke krijuar në këtë mënyrë një praktikë shkresore dhe dixhitale për ankesat.

12.2. Rekomandimi:Titullari i institucionit të caktojë, me urdhër një grup të veçantë për shqyrtimin e ankesave të cilët do administrojnë dhe databazën e ankesave, ku në përbërje të ketë domosdoshmërisht një jurist dhe një specialist të Sektorit të Legalizimeve dhe Hartografisë.

Koment - Shqyrtimi i kërkesave/ankesave kryhet nga specialistët dhe përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë dhe Juridike.

-Sipas rregullores është detyra funksionale e këtij sektori për këtë rekomandim.

Bashkëlidhur tabela e ankesave të drejtorisë

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

1. Gjetje nga auditimi: DVASHK Zonat e Stimuluara për efekt të përshpejtimit dhe përballimit të ngarkesës së legalizimeve, krahas organikës ka punësuar edhe punonjës provizor, duke lidhur kontrata pune për vitin 2018, 2019 dhe 2020 me miratim të Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK sipas vendimit 23 datë 26.12.2019. Kështu për vitin 2020 organika përbëhet nga 20 punonjës, ndërsa punonjës provizor paraqiten 25 persona nga 690 gjithsej DPASHK. Nga auditimi u konstatua se:

a.numri i punonjësve provizore për 3 vitet(2018-2019-2020)paraqitet më i lartë se numri i punonjësve në organike, në vend që të ndodhte e kundërta, çka tregon se planifikimi i numrit punonjësve krahasuar me nevojat e punës nuk ka qenë i saktë.

b. nuk janë lidhur kontrata definitive për punonjësit provizor, në zbatim të Kodit Punës, pasi punësimi i tyre ka kaluar periudhën mbi 3 vjet (2018-2021), duke vazhduar procesi me kontratë të përkohshme.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Komente: -por i arsyetuar në shkresën nr. 9108 prot., datë 29.04.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Sipas Lejeve të legalizimit si vijon: Leja e legalizimit me nr. 704570, datë 31.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 704942, datë 30.09.2019; Leja e legalizimit me nr. 705666, datë 28.10.2020; Leja e legalizimit me nr. 705712, datë 14.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705713, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705737, datë 22.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705715, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705716, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705722, datë 16.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705714, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit 704808 datë 28.06.2019; Leja e legalizimit nr. 705443 date 29.07.2020; Leja e legalizimit nr. 705451 date 25.08.2020 dhe Leja e legalizimit nr. 704856, datë 23.09.2019, lartësia e objekteve (numri i kateve) është më e lartë sesa ajo e përcaktuar në “Planet e Përgjithshme Vendore” të Bashkive përkatëse. Sipas VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, lartësia e objekteve e përcaktuar sipas dokumenteve të planifikimit të territorit nuk është kriter për përjashtimin e subjekteve nga legalizimi.

2.1. Rekomandimi:Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, duke marrë shkas nga pasojat që shkaktoi tërmeti i vitit 2019, të marrë masa për hartimin e ndryshimeve ligjore dhe t’u propozojë për miratim organeve përkatëse, në lidhje me përfshirjen e lartësisë së ndërtesave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit, si kriter për kualifikimin/skualifikimin nga procesi i legalizimit.

Komente: Me shkresën nr. 9108 prot., datë 29.04.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, jemi njoftuar se kjo problematikë është parashikuar në nenin 20 pika 1/c e ligjit nr. 20/2020.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave mbi page të DVASHK Zonat e Stimuluara, për vitin 2018-2019-2020, u konstatua se: Në mënyrë të pa argumentuar është përfituar zëri shtesa mbi page “për kushte pune tjera”, pasi nuk përcaktohen se cilat janë këto kushte të tjera dhe kjo është aplikuar vetëm për institucionin e ASHK, sipas listë pagesave të vitit 2018, 2019 dhe 2020. Kjo shtese për “kushte pune tjera” është përfituar për 3 vitet nga gjithë personeli prej 37 personash duke përfshirë dhe punonjësit provizor me nga 5,000 lekë/muaj deri 20,000 lekë/muaj për secilin ose gjithsej rreth 5 milion lekë për çdo vit. Pagesa e shtesës “për kushte pune tjera” bazohet tek VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK”, vendimi cili nuk flet për këtë shtese, por thotë referuar lidhjes nr. 2, ku edhe kjo lidhje nuk flet dhe nuk identifikon kushtet e tjera të punës, por pasqyron vlerat sipas punonjësve në një kolonë të veçantë.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të ndërpresë menjëherë shtesën e pagës “për kushte pune të tjera”, si të pajustificuar dhe pa mbështetje ligjore, në të kundërt në bashkëpunim me KM të saktësojë dhe përmirësojë VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK” dhe lidhjen nr. 2, të cilat nuk përcaktojnë asnjë kusht pune.

Komente: -Arsyetuar me shkresën nr. 9108 prot., datë 29.04.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar.

1. Gjetje nga auditimi: DVASHK Shkodër ka regjistruar pasurinë nr. 402/13/1, ZK 3072, Velipojë, sipas Lejes së legalizimit nr. 704226, datë 17.07.2018, dhe pasurinë nr. 208/1, ZK 3072, Velipojë, sipas Lejes së legalizimit nr. 704853, datë 23.09.2019. Nga verifikimi i origjinës së truallit mbi të cilat janë ngritur ndërtimet pa leje, nga shqyrtimi i kartelave të pasurive të paluajtshme rezulton se janë të regjistruar objekte “Shtet”, ndërkohë që në praktikat e regjistrimit nuk administrohet asnjë deklaratë noteriale në lidhje me ndërtimet pronë shtet, për prishje apo ngritje të ndërtimit të ri, si dhe nuk ka vërtetim nga organet shtetërore në lidhje me administrimin dhe gjendjen aktuale të pronës shtetërore, sipas përcaktimeve të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi:

DV ASHK Shkodër të marrë masa për vendosjen e kufizimit për pasuritë e mësipërme deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor me deklaratën noteriale në lidhje me ndërtimet pronë shtet, për prishje apo ngritje të ndërtimit të ri.

Komente *Me shkresën nr. 9686 prot., datë 20.09.2022, është informuar institucioni jonë mbi zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Shkodër*
Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Sipas kërkesës me nr. 564 prot., datë 18.05.2021 dhe me nr. 564/1, datë 19.05.2021 nga shoqëria “J” sha, janë paraqitur pretendimet për rishikimin e rekomandimit nga KLSH përse i përket vendosjes së kufizimit nga ish-ZVRPP Shkodër mbi pasuri nr. 193/36 të regjistruar në ZK1945 vol. 8 faqe 241 me sipërfaqe 3885m² truall dhe 450.8 m² ndërtesë. Sipas kërkesës së bërë nga “J” sha, pretendohet se leja e ndërtimit është nënshkruar nga Kryetari i KRRT të Komunës Rrethina për atë kohë z.G. H, dhe jo siç pretendohet nga grupi i auditimit të KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Bashkëlidhur gjendet edhe fotokopje e Vendimit të KRRT nr. 18, datë 01.10.2010 së bashku me fotokopjen e planimetrisë së sheshit të ndërtimit. Nga shqyrtimi i fotokopjes së Vendimit të KRRT nr. 18, datë 01.10.2010, rezulton se është miratuar dhënia e sheshit të ndërtimit për subjektin “A-P” sh.a., nënshkruar nga Sekretari i KRRT A. S. dhe Kryetari i KRRT G. H.

Nga verifikimi dhe krahasimi i këtij dokumentacioni me atë të ndodhur në referencë nr. 3180, datë 12.01.2015, rezultojnë se kanë përmbajtje tjetër.

Nga shqyrtimi i Vendimit të KRRT nr. 18, datë 01.10.2010, të ndodhur në referencë nr. 3180, datë 12.01.2015, rezulton se është miratuar dhënia e sheshit të ndërtimit për subjektin “J” sh.a., e panënshkruar nga Sekretari i KRRT, por e nënshkruar nga N/Kryetari i KRRT Gj. P. Pra kemi të bëjmë me dy dokumente me përmbajtje të ndryshme përse i përket subjektit të cilit i është miratuar dhënia e sheshit të ndërtimit dhe nënshkrimet.

Sipas referencë nr. 04537, datë 26.05.2021 është hequr kufizimi në seksionin “E” të kartelës duke shënuar “Hiqet kufizimi i KLSH si rezultat i plotësimit të dokumentacionit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në këtë praktikë, rezultoi se qytetari, ndër të tjera, ka depozituar fotokopje të Vendimit të KRRT nr. 18, datë 01.10.2010, sipas së cilit është miratuar dhënia e sheshit të ndërtimit për subjektin “A-P” sh.a., nënshkruar nga Sekretari i KRRT A. S dhe Kryetari i KRRT G. H, pra me përmbajtje të ndryshme nga vendimi sipas të cilit është kryer regjistrimi dhe që nuk përbën plotësim dokumentacioni. Pasuria rezulton e kufizuar

2.1. Rekomandimi: DVASHK Shkodër, duke qenë se i janë paraqitur dokumente në fotokopje dhe me përmbajtje të ndryshme nga praktika origjinale e regjistrimit, të marrë masa që Njësia Administrative e cila ka lëshuar aktet administrative, t'i kërkojë informacion dhe konfirmimin përse i përket vërtetësisë së dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dokumentacionit në përputhje me nenin 68 “Bashkëpunimi ndërinstitucional” të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”. Në rast se dokumentacioni konfirmohet si i rregullt nga ana e Njësia Administrative, atëherë të vijohet me heqjen e kufizimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

A. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës në DVASHK Zonat e Stimuluara u konstatuan shkelje financiare në 2 raste për vlerën 53,000 lekë, shpenzime të pajustificuara, konkretisht:

* vlera 33,000 lekë, shpenzime pastrimi të pajustificuara, sipas urdhër shpenzimit nr. 49 datë 18.07.2019, pasi: institucioni ka të punësuar në organike pastrues, madje pastrimi (dizefektimi) i zyrave AKSH është kryer njëherë nga “N-86” shpk (urdhër shpenzimit 50 datë 18.07.2019) si dhe praktika e pagesës paraqet mangësi dokumentare (mungon projekti, preventivi, situacioni i sipërfaqes gjelbëruar). Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

* vlera 20,000 lekë, tatim në burim, sipas urdhër shpenzimit nr. 48 datë 18.07.2019 dhe MP datë 21.08.2020, pasi 2 faturat e thjeshta nr. 2, datë 04.08.2020 dhe 16.07.2019 për vlerën 200,000 lekë nuk janë të modelit tatimor, Çka ka krijuar efekt negativ financiar, në kundërshtim me pikën 52 të UMF 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me VKM 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypin dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor” .

1.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara të nxjerrë përgjegjësitë për sa më sipër dhe të marrë masa në të ardhmen, për shpenzimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve në mënyrë që të eliminohet probabiliteti i mundësisë së krijimit të efekteve negative financiare.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet në proces.

II. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga DVASHK Zonat e Stimuluara, legalizimi i objektit informal, sipas lejes së legalizimit nr. 705118, datë 17.12.2019 object banimi 2-kat, pasuria nr. 8/91/1, ZK3101, Qerret, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: DVASHK Zonat e Stimuluara, për rastin e evidentuar më sipër, të kërkojë nga DVASHK Durrës statusin juridik të pronës dhe nëse objekti figuron në kartelat e pasurive të paluajtshme i regjistruar në emër të përfituesit të lejes së legalizimit, të kërkojë kufizimin e pronës dhe të fillojë procedurat ligjore për shfuqizimin e kësaj leje.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

1. Gjetje nga auditimi: DVASHK Zonat e Stimuluara për efekt të përshpejtimit dhe përballimit të ngarkesës së legalizimeve, krahas organikës ka punësuar edhe punonjës provizor, duke lidhur kontrata pune për vitin 2018, 2019 dhe 2020 me miratim të Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK sipas vendimit 23 datë 26.12.2019. Kështu për vitin 2020 organika përbëhet nga 20 punonjës, ndërsa punonjës provizor paraqiten 25 persona nga 690 gjithsej DPASHK. Nga auditimi u konstatua se:

a. numri i punonjësve provizore për 3 vitet (2018-2019-2020) paraqitet më i lartë se numri i punonjësve në organike, në vend që të ndodhte e kundërta, çka tregon se planifikimi i numrit punonjësve krahasuar me nevojat e punës nuk ka qenë i saktë.

b. nuk janë lidhur kontrata definitive për punonjësit provizor, në zbatim të Kodit Punës, pasi punësimi i tyre ka kaluar periudhën mbi 3 vjet (2018-2021), duke vazhduar procesi me kontratë të përkohshme.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave mbi page të DVASHK Zonat e Stimuluara, për vitin 2018-2019-2020, u konstatua se: Në mënyrë të pa argumentuar është përfituar zëri shtesa mbi page “*për kushte pune tjera*”, pasi nuk përcaktohen se cilat janë këto kushte të tjera dhe kjo është aplikuar vetëm për institucionin e ASHK, sipas listë pagesave të vitit 2018, 2019 dhe 2020. Kjo shtese për “*kushte pune tjera*” është përfituar për 3 vitet nga gjithë personeli prej 37 personash duke përfshirë dhe punonjësit provizor me nga 5,000 lekë/muaj deri 20,000 lekë/muaj për secilin ose gjithsej rreth 5 milion lekë për çdo vit. Pagesa e shtesës “*për kushte pune tjera*” bazohet tek VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “*Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK*”, vendimi cili nuk flet për këtë shtese, por thotë referuar lidhjes nr. 2, ku edhe kjo lidhje nuk flet dhe nuk identifikon kushtet e tjera të punës, por pasqyron vlerat sipas punonjësve në një kolonë të veçantë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të ndërpresë menjëherë shtesën e pagës “*për kushte pune të tjera*”, si të pajustificuar dhe pa mbështetje ligjore, në të kundërt në bashkëpunim me KM të saktësojë dhe përmirësojë VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “*Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK*” dhe lidhjen nr. 2, të cilat nuk përcaktojnë asnjë kusht pune.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

III. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Projekraportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

a. Akt Verifikimi:

Akt Verifikimi Nr. 1 datë 23.09.2022 “Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna”

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport –Përfundimtar auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT